

**BARDHYL DEMIRAJ**

**DISA ÇIFTE MBIEMÉRORE TË TIPIT  
DITOR-NJËDITOR NË GJUHËN LETRARE SHQIPE**

Formimi i fjalëve të reja si edhe zhvillimi i kuptimeve të reja te fjalët përbëjnë dy rrugët kryesore për pasurimin e gjuhës së sotme letrare shqipe me njësi të reja leksiko-semantike. Këto dy procese nuk shihen si dy drejtime të pavarura nga njëri-tjetri, por në unitet dialektik, i cili, në larmishmérinë e vet, gjen shprehje edhe në llojin e kundërvénieve diferençuese semantike e formale që vendos fjala në kushtet e lëvizjes së pandërprerë të shtresave të leksikut, gjatë zhvillimit të tij historik. Rezultat i këtyre kundërvénieve është edhe përfthimi i disa çifteve fjalësh të një tipi të veçantë, të cilat përbëjnë edhe objektin e kësaj trajtese.

Është fjalë këtu për disa çifte mbiemrash, gjymtyrët e të cilave dallohen nga njëra-tjetra nëpërmjet pranisë ose mungesës së numërorit një të paravendosur: *i anshëm* — *i njëanshëm*, *i vlershëm* — *i njëvershëm*, *kuptimor* — *njëkuptimor*, *qendor* — *njëqendor*, *boshor* — *njëboshor*, *ditor* — *njëditor*, *javor* — *njëjavor* etj. Gjymtyra e dytë e secilit çift, në pjesën më të madhe, është e një moshe më të re, e kufizuar në përdorim kryesisht në fushën e ligjërimit bisedor<sup>1</sup>. Një numër i madh njësisë ndeshen edhe në fushën e terminologjisë shkençore: *gjethor* — *njëgjethor*, *thelbor* — *njëthelbor*, *qelizor* — *njëqelizor*, *thundrak* — *njëthundrak*, *votor* — *njëvotor*, *boshor* — *njëboshor*, *buzor* — *njëbuzor*, *bazik* — *njëbazik* etj.<sup>2</sup> Por për specifikën që kanë, ato duhen trajtuar më vete.

Gjer më sot, gjymtyrët e këtyre çifteve janë hulumtuar thuajse shterueshëm në rrafshin formal. Kështu, gjymtyra e parë e secilit çift është fjalë e prejardhur me prapashtesim nga një temë emërore. SHEMA gjithëpërfshire e kësaj strukture, sipas sistemit të simboleve të përdorur nga J. Thomai<sup>3</sup> del (*n+*) *tE + f* — *M: javë-or*, *i vlerë-shëm*, *i anë-shëm* etj. Gjymtyra e dytë është shpjeguar si një fjalë e përbë-

1) Këto njësi gjejnë vend për herë të parë në mënyrë të plotë në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe» (1980). Në «Fjalorin e gjuhës shqipe» (1954) ndeshen vetëm: *i njëanshëm* dhe *i njëhershëm*. Shih: A. Kostallari, *Mbi disa drejtime të përsosjes së sistemit e të strukturës së gjuhës sonë letrare*, SF, 2, 1982, f. 20.

2) Në FGjSh (1954) si çift-term ndeshet vetëm *thundrak-njëthundrak*.

3) J. Thomai, *Formimi i fjalëve dhe prejardhja kuptimore në gjuhën shqipe*, SF, 3, 1983. Nga lista e simboleve të përdorura nga ky autor përmendim:

*n* nyje

M Mbiemër

*tE* temë emërore

tNum temë numërore

*tM* temë mbiemërore

f formant

rë me skemë ( $n+$ )  $tNum + tM \longrightarrow M^4$ : *një-javor, i një-vlershëm, i një-anshëm*. Kohët e fundit me daljen e teorisë së sindajshtesave, kjo skemë është lëkundur, duke iu bashkuar skemës ( $n+$ )  $f + tM \longrightarrow M^5$ .

Fiksimi i tipit të fjalëformimit për gjymtyrën e dytë të çifteve në shqyrtim (*i njëanshëm, i njëvlershëm* etj.) me madhësitë fjalëformuese përkatëse — me skemë ( $n+$ )  $f(tNum) + tM \longrightarrow M$  — e veçon qartë këtë klasë mbiemrash nga klasa tjetër (*njëvëllimësh, njëfarësh, njëgjetësh* etj.), që mbartin numërorin *një*, por që dalin me tjetër strukturë fjalëformuese ( $n+$ )  $f(+Num) + tE + f \longrightarrow M^6$ . Te kjo klasë del si temë prodhuese *një* emër: *vëllim, farë, gjethë*, etj., ndërsa numërori është kurdoherë i pamungueshëm<sup>7</sup>.

Po ta kalojmë kahun e trajtimit në rrafshin kuptimor, që në *një vështrim* të parë bie në sy se gjymtyrët e secilit çift, si *njësi* leksikore të veçanta, mbartin kuptime të lidhura organikisht me *njëri-tjetrin*, por me diapazon leksiko-semantik të ndryshëm, i cili ndër të tjera, kush tëzon edhe llojin dhe shkallën e marrëdhënive diferencuese që vendos secila *njësi* me *njësitë* e tjera të klasave të afërta. Kështu, p.sh., *njësia anësor* përdoret, kur duam të vëmë në dukje diçka që «*gjendet* në *anë* të *një* sendi a *vendi*», pra jo në *qendër*: *faque anësore, gjethë anësore* etj. Në këtë rast, lloji i marrëdhënies që vendos kjo *njësi*, ka të bëjë me pozicionin e sendit të përcaktuar, çka duket edhe në marrëdhëni kundërvënëse që vendos *njësia anë* (tema prodhuese) me *njësinë qendër*. Pra, vendoset marrëdhënia *anësor* — *qendor*. Ndërsa *njësia njëanësor* mbart *një* kuptim më të specifikuar. Ajo përdoret për të vënë në dukje jo aq faktin se diçka gjendet në *anë* të *një* sendi, dukurie a *vendi*, sesa *një* fakt tjetër i ngritur mbi të parin: që gjendet vetëm në *njëren anë* nga dy a më shumë *anë* të mundshme që mund të ketë *një send* ose *dukuri*, p.sh. *lulesë njëanësore, tingull njëanësor*. Në këtë rast, *njësia e re* vendos *një* lloj tjetër kundërvënieje, e cila, në *vija* të *traشا, shfaqet* në marrëdhëni që vendos togu *një anë : një anë — më shumë se një anë*.

Marrëdhënie të ngjashme midis gjymtyrësh vërehen edhe në rast se do të merreshin në shqyrtim çifte të tjera fjalësh, si: *i anshëm — i njëanshëm, kuptimor — njëkuptimor* «që ka *një* kuptim», *qendor* —

4) Shih A. Dhrimo, Kap. *Mbiemri* në «Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe», II, 1976, f. 106; së fundi edhe F. Agalliu në *Formimet e tipit kompozitë + prapashtesë* në *gjuhën shqipe*, SF, 2, 1987, f. 18v.

Do vërejtur se kjo skemë fjalëformuese merret si gjithëpërfshirëse vetëm në planin sinkronik. Ndërsa në planin diakronik ka edhe *njësi* që nuk i nënshtron kësaj skemë. Kështu p.sh. në çiftin *gjakës-njëgjakës* *njësia njëgjakës* është formuar më fort nëpërmjet njëfjalëzimit të togut *një gjak* me *prapashtësën -ës* ( $tNum + tE + f - M$ ) sesa drejtpërdrejt nga *njësia gjakës*. Çifte të tillë në këtë trajtesë janë lënë jashtë vështrimit.

5) H. Bussman, *Lexikon der Sprachwissenschaft*, Stuttgart, Kvöher 1983, f. 12; E. Hysa, *Sindajshtesat dhe vendi i tyre* në *formimin e fjalëve* në *gjuhën shqipe*, SF, 1986, 2, f. 97.

6) FGjSSh (1980), f. 1292, 1285; A. Dhrimo, në vendin e cituar, f. 166. Kjo skemë del nga vështrimi i problemit në planin sinkronik. Për planin diakronik shih Sh. Demiraj, *Gramatikë historike e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1986, f. 415.

7) Formime të mëvetësishme pa numëror, si: *vëllimësh, farësh, gjethesh* etj., me funksion mbiemër, nuk ekzistojnë në *gjuhën shqipe*. Shih F. Agalliu, në art. cit, f. 19 v.

— njëqendror, i vlershëm — i njëvlershëm, ditor — njëditor, etj. Ndryshët, vendi i gjymtyrëve ndaj njëra-tjetrës për secilin çift është i ndryshëm. E kjo është e lidhur kryesisht me vlerën modifikuese të numërorit *një<sup>8</sup>*, si edhe me faktorë të tjerë, si: koha e formimit të njësisë së re leksikore, fusha dhe denduria e përdorimit të saj, ngjyrimi stilistik etj., gjë që e përforcon dhe e specifikon edhe më shumë përbajtjen leksikore të gjymtyrëve. Kjo vërehet fare mirë edhe në «Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe» (1980). Kështu raportet semantike që vendosin ndaj njëra-tjetrës gjymtyrët e çiftit *qendror — njëqendror*, s'janë të njëjtë me ato të çiftit *i anshëm — i njëanshëm* ose me ato të çiftit *i vlershëm — i njëvlershëm*, e kështu me radhë.

Veçse, të vështuar në një plan më të përgjithshëm, gjymtyrët e seçilit prej këtyre çifteve, megjithë vendin e ndryshëm që zënë në raport me njëra-tjetrën, kanë të përbashkët një bosht semantik ku çdo njësi e re leksikore, me skemë (*n+*)  $f(tNum) + tM \longrightarrow M$ , është, ndër të tjera, rezultat i përfimit të kundërvënieve<sup>9</sup> diferençuese kuptimore e fjalëformues të njësisë prodhuese, me skemë: (*n+*)  $tE + f \longrightarrow M$ , gjatë përdorimit dhe përpunimit kuptimor të saj në sistemin ligjërimor dhe stilistik të gjuhës. Në një përfundim të tillë vijmë nëpermjet analizës semantike dhe fjalëformues që u bëjmë gjymtyrëve të seçilit çift<sup>10</sup>. Për ilustrim po marrim në shqyrtim çiftin *ditor — njëditor*, si mbiemra që kanë bazë rrëniore një emër (*dité*), që shënon një fragment kohe.

Në rast se do të marrim në shqyrtim strukturat kuptimore të seçilës gjymtyrë, del se njësia *ditor* (FGjSSh, f. 345), «trashëgon» nga njësia prodhuese *díté* (FGjSSh 343), tri kuptimet e para, të cilat i modifikohen në dy ( $F_1 \dots 10 \longrightarrow Fa_{1,2-3}$ : 1) «Që është vetëm për ditën, që bëhet ditën, që punon vetëm ditën», shemb: *Cerdhe ditore, kinema ditore, kopësht ditor, shfaqje ditore* etj. 2) «Që lidhet me ditën, i ditës. . .». Shemb.: *Temperaturë ditore, plani (norma) ditore, prodhim ditor, shërbimi ditor, regjimi ditor, paga ditore* etj. Gjatë analizës semantike ne do të përqendrohem vetëm në kuptimin e dytë të kësaj njësie<sup>11</sup>. Kur-

- 8) Nga shqyrtimi që u kemi bërë njësive leksikore me skemë fjalëformuese (*n+*)  $f(tNum) + M \longrightarrow M$  në FGjSSh, madhësia *një shfaqet* me këto vlera modifikuese: a) Ideja e numrit. Kjo kryesisht në terminologjinë shkencore: *njëgjethor, njëqendror, njëqelizor, njëvetor, njëboshtor* etj.; b) Njëjtësi, barazi me diçka tjetër të sjellë për krahasim: *i njëvlershëm, i njënjëshëm* etj.; c) Roli hiperkarakterizues *i njëhershëm* «i dikurshëm», *njëemnak*. Në fjalë të formuara herët e me ngjyrim afektiv (*i njëanshëm, i njëzëshëm*) është vështirë të përcaktohet me saktësi vlera modifikuese e kësaj madhësie.
- 9) Me kundërvënie kuptimore ose formale këtu kuptojmë shembëllimin e marrëdhënieve diferençuese që vendosin dy elemente të një grupi paradigmatik. Shih: *Dictionnaire de linguistique Larousse*, 1973, f. 347-348.
- 10) Kjo ndarje është bërë për arsyen semantike dhe nuk duhet kuptuar aspak në mënyrë mekaniciste, sepse fjalë si njësi e veçantë leksiko-gramatikore funksionon në gjuhë si një e tërë e pandashme. Shih A. Kostallari, *Mbi disa vëçori të fjalës në gjuhën shqipe*, në «Studime mbi leksikun. . .», I, 1982, f. 82.
- 11) Është pikërisht nociioni i kohës prej 24 orësh ose i një kohe të caktuar brenda javës, muajit a vitit, i cili pasqyrohet edhe në kuptimin e njësisë *njëditor* e që trashëgohet nga baza rrëniore *díté* me kuptimin 2,3 të saj. Me këtë kuptim njësia *díté* hyn në kundërvënie me masat e tjera të kohës: *orë, javë, muaj* etj. P.sh.: *Gjatë planifikimit të pagës së punës dallojmë fondin orar, fondin ditor dhe fondin mujor të pagës së punës* (P. Xhuvani, «Ekonomia e industrisë në RPSh», Tirana, 1969, f. 362).

se njësia *njëditor* «trashëgon» vetëm një kuptim të njësisë prodhuese *ditor* ( $F_{1,2}$  —  $F_{2,2}$ ): «Që zgjat një ditë, që kryhet brenda një dite», Shemb.: *Ekskursion njëditor, grevë njëditore*.

Nga shpjegimi i dhënë me shembujt përkatës nuk është vështirë të kuptohet se ç'i bashkon nga ana semantike dy njësitë e marra në shqyrtim. Një qartësim të mëtejshëm na e jep zërthimi i strukturës kuptimore të tyre në përbërësit kuptimore (njësitetë semantike minimale)<sup>12</sup>. Kështu, njësia *ditor* në kuptimin 2 të saj del me këta përbërës:

1. Lidhet me ditën si dukuri natyrore; 2. Kohë; 3. E përcaktuar me saktësi; 4. Që ndodh rregullisht a në intervale të pashkëputura nga njëra-tjetra.

Kurse njësia *njëditor*:

1. Lidhet me ditën si dukuri natyrore; 2. Kohë; 3. E përcaktuar me saktësi; 4. Që ndodh vetëm një herë ose në intervale të shkëputura nga njëra-tjetra.

Nga ky zërthim i strukturave kuptimore në përbërës kuptimore të veçantë del qartë se dy njësitë largohen nga njëra-tjetra vetëm në përbërësin 4. Ndërsa njëra njësi (*ditor*), e përdorur me kuptimin në shqyrtim (shih shën. 11), përcakton një proces që ndodh në mënyrë të rregullt e me kohëzgjatje të caktuar, njësia e dytë (*njëditor*) përcakton një proces që ndodh vetëm një herë e me të njëjtën kohëzgjatje. Por diferençimi i këtyre dy njësive ka të bëjë më fort me faktin se cili përbërës është më i genësishëm për çdo njësi. Kështu, ndërsa për *ditor* si më të qenësishëm janë përbërësit 2 dhe 3, për *njëditor* del përbërësi 4. Dhe janë pikërisht këto dallime që kushtëzojnë diferençimin kuptimore të këtyre njësive e që vazhdojnë të thellojnë edhe më shumë atë. Le të japim nga një shembull për çdo njësi. Për *ditor*: ... *kryesia e kooperativës* ka përcaktuar për çdo brigadë e individ një normë ditore mjaft të avancuar. («Zëri i popullit», 20.VIII.1968, f. 1); për *njëditor*: *Me propagandistët e rrëthit të Fierit u zhvillua një seminari njëditor*. («Zëri i rinisë», nr. 80, f. 2).

Porse mospërputhja *qenësor* — *jogenësor* në përbërësin 4 për njësitë në shqyrtim çon herë pas here, në procesin e ligjërimit, edhe në gërshtimin e fushave semantike të tyre, aq sa krijon përshtypjen se përbërësi 4 i njësisë *njëditor* gjallon si jokryesor së bashku me përbërësin 4 të njësisë *ditor*. Kjo mundësi potenciale vërehet edhe sot e kësaj dite gjatë përdorimit të fjalës në numrin shumës. Kështu, p.sh., *Ekskursione ditore* s'ka sot për sot ndonjë dallim leksiko-semantik nga *ekskursione njëditore*. Përfocimi semantik që jep madhësia *një* — mbetet hiperkarakterizues (ridondant). Shemb.: ... *i takuam në zyrë me evidencat e notave ditore përparrë*... («Mësuesi», Nr. 3, 1963, f. 2); ... *ka munguar nxjerrja e rezultateve ditore e njohja me to*... («Zëri i popullit», Nr. 60, 1972, f. 3); *Në programet mësimore parashikohet organizimi i dy ekskursioneve njëditore* në vit. («Arsimi popullor», Nr. 1, 1960, f. 50); ... *inspektorët vazhdojnë të bëjnë vizita njëditore* në shkolla pëtë gjitha çështjet (Po aty, Nr. 1, f. 19).

12) Për zërthimin e kuptimit leksikor të fjalës në njësitë semantike minimale, shih më gjerë: J. Thomai, *art. cit.*, f. 87 v; dhe *Leksikologja e gjuhës shqipe*. Tiranë, 1984, f. 48.

Këto njësi ndërrojnë vendet me njëra-tjetrën edhe në ligjërimin e pakontrolluar mirë. Shemb.: Rezerpina përdoret me dozë ditore 0.1-0.25 mg. dhe rrallë përdoren dozat mbi 0.5 mg. (P. Kokalari — N. Misiri «Bazat e farmakologjisë stomatologjike», Tiranë, 1971, f. 187); *Nevoja njëditore për vitaminë C plotësohet me 50 gr të lakkres së kuqe, majdanozit... («Zëri i rinisë», Nr. 55, 1961, f. 4); ... përdoret dy herë në ditë, duke bërë dy të tretat e dozës ditore në mëngjes dhe një të tretën në darkë.* (H. Peçi, «Diabeti», Tiranë, 1973, f. 47).

Gërvhetimi i fushave semantike ndodh sot edhe për arsyen se njësia njëditor është formuar rishtas në gjuhë, ka një fushë të ngushtë përdorimi (ligjërimi libror), madje në rrethana të veçanta, kur duam të përcaktojmë me saktësi jo aq kohëzgjatjen e një procesi sesa shtrirjen në kohë të tij. Në këtë rast, interes të veçantë paraqet studimi i lidhjeve hiponimike që vendosen midis bazës rrëniore, fjalës prodhuese e fjalës së prejardhur, si edhe përcaktimi i kufijve të saktë midis zhvillimeve kuptimore të jashtme e të brendshme në strukturën e secilës njësi. Prandaj analiza kuptimore ka nevojë të shtrihet gjatë vijës ditë — *ditor — njëditor*.

Nëpërmjet ballafaqimit të strukturave kuptimore në raportin *njësi prodhuese — njësi e prejardhur*, jemi në gjendje që të ndjekim edhe lëvizjet kuptimore, drejtimet dhe shkallëzimet e tyre. Kjo lëvizje e marrë në vijë lidhëse pér të tri njësitet del: A<sub>2,3</sub> — B<sub>2</sub> — C. Pra kuptimet 2,3 të bazës rrëniore ditë përbëjnë thelbin semantik të kuptimit 2 të njësisë *ditor*. Së bashku me to kjo njësi mbart edhe llojet e atyre marrëdhënieve diferençuese që vendos baza rrëniore ditë me kuptimet përkatëse në rrëthin paradigmatik, ku bën pjesë. Kështu, kjo bazë e përdorur si njësi më vete me kuptimet në fjalë hyn në dy lloj kundërvéniesh të vendosura në dy plane. Në njërin plan kemi kundërvénien *ditë — jo ditë* (orë, javë, muaj etj. si fragmente kohe). Në planin tjeter kemi kundërvénien *ditë — më shumë se një ditë*. Kjo lloj kundërvénieje realizohet në gjuhë nëpërmjet togjeve të lira *numëror + emër: një ditë — dy ditë, tri ditë* etj. Në këtë rast numërori nga pikëpamja sintaksore luan rolin e një përcaktori, përdorimi i të cilit, ndërsa pér njërin skaj të kundërvénies (*më shumë se një ditë*) del i qenësishëm, pér skajin tjetër (*një ditë*) nuk është i domosdoshëm. Përcaktori *një* i jep njëfarë ngushtimi gjëresisë kuptimore të fjalës, por nuk është edhe aq relevant pér të, pér arsyen se një kuptim i tillë del në njëfarë mase edhe nga kuptimet gramatikore që shfaqin treguesit gramatikorë të numrit si shquarsisë e të pashquarsisë së fjalës ditë si edhe lidhjet sintaksore që vendos kjo njësi në rastin konkret.

Rrethana të ngjashme me ato që ndeshen në temën prodhuese vërehen edhe në njësinë e prejardhur *ditor*<sup>13</sup>. Ajo vendos marrëdhënie kundërvéniet diferençuese të kuptimeve dhe literaturën përkatëse: J. Thomai, *Tipat...*, f. 88.

13) Te njësia *ditë* kemi edhe një kundërvénie të tretë, që zhvillohet ndërmjet strukturave të kuptimeve 2 dhe 3 Kjo kundërvénie zbulohet vetëm me anë të një përfytyrimi konkret. Shih pér përcaktimin e treguesve të ndryshëm në kundërvéniet diferençuese të kuptimeve dhe literaturën përkatëse: J. Thomai, *Tipat...*, f. 88.

dërvënëse nga njëra anë me *javor*, *mujor* etj., nga ana tjetër me *dyditor*, *treditor* etj.<sup>14</sup>

Siq e thamë edhe më lart, semantika e temës prodhuese *ditë përbën* përgjithësisht thelbin kuptimor të fjalës së prejardhur *ditor*. Porse në përfimin e përmbajtjes leksikore të saj ndikojnë drejtpërsëdrejti ose tërthorazi edhe madhësitë e tjera, si kategoria leksiko-gramatikore e sidomos formanti fjalëformues, i cili sjell ndryshime semantike të karakterit kategorial e leksikor në njësinë e prejardhur. Kështu formanti *-or*<sup>15</sup> (*dit-* + *-or*), si formant mbiemër, tregon marrëdhënien e procesit a të dukurisë së karakterizuar, ndaj një procesi tjetër. Si pasqyrim i këtyre marrëdhënieve e në përputhje me situata të ndryshme të ligjërimit në të cilat kuptohet dukuria a procesi që karakterizon<sup>16</sup>, njësia e prejardhur *ditor* zhvillon përbërës të rinj kuptimorë, të cilët kushtëzojnë edhe lindjen e kundërvënieve të reja diferencuese, krahas atyre «të trashëgura». Është fjala këtu për përbërësin «i përditshëm; që ndodh rregullisht e në intervalë të caktuara»: *plan ditor*, *normë ditor* etj.

Zhvillimi i këtij përbërësi në përmbajtjen leksikore të fjalës çon në lindjen e një marrëdhënieje të re e differencuese, që jepet nëpërmjet lidhjes (raportit) *vetëm një ditë — çdo ditë*. Kjo kundërvënie, në rast se do të zhvillohej brenda strukturës kuptimore të njësisë në shqyrtim, do të përfaqësohej me dy nuanca semantike antonimike, më saktë enantiosemike<sup>17</sup>. Veçse kjo kundërvënie e re e krijuar në strukturën leksikore të njësisë në shqyrtim nuk do të lejonte qarkullimin e saj në ligjërim për një kohë të gjatë. Dhe kjo për arsyen se brenda kësaj strukture do të gjallonin dy përbërës enantiosemikë, që përjashtojnë njëri-tjetrin e si të tillë do të sillnin pështjellime në komunikim. Kështu me kohë lind nevoja që njëri përbërës të bjerret ose të dalë më një strukturë të re fonetike-fjalëformuese, në mënyrë që ta dallojë edhe formalisht nga i pari. E kjo u arrit me anë të ristrukturimit formal të përbërësit «vetëm një ditë», nëpërmjet fiksimit të numërorit *një*, të paravendosur njësisë përkatëse *ditor*.

Duke u fiksuar në këtë strukturë — (n+) *f(tN)* + *tM* — M — e me këtë përdorim, numërori *një*, krahas kuptimit leksikor kategorial që ka, bëhet edhe mbartës i kuptimeve leksikore plotësuese, gjë që i vesh atij cilësitë e një formanti në strukturën (*f* + *tM* — M). Në

14) Përdorimi i një strukture fjalëformuese *njëditor* do të përligjë vetëm në ato raste kur kundërvënia do të shfaqej brenda fjalisë a frazës. Shemb.. *Ekursionet njëditore ndryshojnë nga ato shumëditoret* («Mësuesi», nr. 36, 1963, f. 3); *Në fillim të vitit shkollor janë organizuar seminare një- dhe shumë-ditore me drejtorët e shkollave dhe me mësuesit e rinj.* («Mësuesi», nr. 44, 1964, f. 3).

15) Ky formant shërben, ndër të tjera, edhe për të formuar mbiemra më kuptim përkatësor. Shih «Fonetika dhe gramatika...», f. 157.

16) Këto dukuri a procese nga pikëpamja leksiko-gramatikore përfaqësohen nga një emër ose një pjesë tjetër e ligjératës e emërzuar. Ndërsa njësia *ditor* si mbiemër s'bën gjë tjetër veçse emërton një tipar të procesit a të dukurisë në fjalë: *regjim ditor*, *pagë ditore* etj.

17) Për enantioseminë në gjuhën shqipe shih M. Samara, *Veçori të antonimisë brenda fjalës në gjuhën shqipe*, SF, 2, 1986, f. 109v.

lidhjen paradigmatike *ditor* — *njëditor* ai del si modifikues i fortë semantik, si plotësues i kundërvënies diferencuese për *herë* — *një herë*<sup>18</sup>. E po ta marrim parasysh këtë, atëherë edhe njësinë e re leksikore *njëditor* nuk do ta shohim thjesht si një formim analogjik të ndikuar nga strukturat fjalëformuese të së njëjtës gjedhe: *dyditor*, *treditor* etj.

Krijimi i njësisë së re leksikore *njëditor* plotëson edhe atë kundërvënie të krijuar ndërmjet strukturave formale *ditor* — *dyditor* që pasqyron kundërvënien kuptimore brenda rrafshit kohor që vendos baza rrëniore *dité*: *një dité* — *më shumë se një dité*. Kjo bën që njësia e re *njëditor* ta zgjerojë gamën e përbërësve kuptimorë, duke u konsoliduar kështu si njësi e veçantë me strukturë leksiko-gramatikore të vetën.

Të njëjtën rrugë të kalimit në një njësi të re leksiko-gramatikore vërejmë edhe për çiftet e tjera që shënojnë fragmente kohe, si: *javor* — *njëavor*, *mujor* — *njëmujor*, *shekullor* — *njëshekullor*. Kundërvëniqet që vendosin gjymtyrët e këtyre çifteve ndaj njëra-tjetrës dhe jash-të njëra-tjetrës, janë proporcionale<sup>19</sup> me ato të çiftit *ditor* — *njëditor* që sapo shqyrtuan.

Në përfundime të ngjashme do të arrinim edhe në rast se do të merrnim në shqyrtim strukturat leksikore e fjalëformuese të çifteve të tjera, si: *i anshëm* — *i njëanshëm*, *anësor* — *njéanësor*, *qendror* — *një-qendror*, *i vlershëm* — *i njëvlershëm*, *kuptimor* — *njëkuptimor*, *gjakës* — *njëgjakës* etj. Të gjitha këto çifte bashkohen rrëth një boshti semantik dhe në analizë të fundit janë rezultat i zgjidhjes së kundërvënieve diferencuese që krijohen në strukturën leksikore të fjalëve gjatë lëvizjes dhe zhvillimeve semantike të vazhdueshme që karakterizojnë përbajtjen e tyre.

\* \* \*

Një gjendje disi e veçantë krijohet me një numër çift-termash nga fusha të ndryshme të shkencës dhe të teknikës, si: *qelizor* — *njëgeli-zor*, *gjethor* — *njëgjethor*, *thundrak* — *njëthundrak*, *bazik* — *njëbazik*, *votor* — *njëvotor* etj. Gjymtyrët e këtyre çifteve, për vetë natyrën e termi shkencor, vendosin ndaj njëra-tjetrës më fort marrëdhënie të pjesës ndaj së tërës dhe sipas rr Ethanave ato mund të ndërrojnë edhe vendet me njëra-tjetrën. Kështu, p.sh., ndërsa me termin *thundrak* në biologji nënkuqtohet një rend gjitarësh i dallueshëm nga rendet e tjera për vetë karakteristikën e tyre se kanë *thundër*, termini *njëthundrak* shënon një familje brenda këtij rendi, e cila është e dallueshme nga familjet e tjera të të njëjtë rend. Në këtë mënyrë, ai gjitar, të cilat i vishet ky term, sipas rr Ethanave përfaqëson herë rendin e herë familjen ku bën pjesë, pa krijuar pështjellime kuptimi në komunikim. P.sh. kali, kur përfaqëson rendin e tij në raport me një përfaqësues të një rendi tjetër, dallohet me termin *thundrak*. Ndërsa në raport me një

18) Pavarësisht nga fufia modifikuese e madhësisë *një*, boshti kuptimor i fjalëve të lidhura mbetet, d.m.th., përbajtja e të dyja fjalëve është «koha prej 24 orësh gjatë së cilës zhvillohet një proces a dukuri».

19) Me kundërvënie proporcionale kuptojmë kundërvënien që vlerësohet për dy elemente dhe që përsëritet edhe në çifte të tjera elementesh të një gjuhe. Shih H. Bussmann, *Lexikon des Sprachwissenschaft*, Stuttgart, 1983, f. 364.

përfraqësues të një familjeje tjetër brenda rendit të thundrakëve (p.sh. lopa, që bën pjesë në familjen e dythundrakëve), dallohet si *njëthundrak*. Pra, ndërmjet elementeve të çift-termave shkencore vendosen marrëdhënie disi të ndryshme nga ato të çifteve në shqyrtim.

\* \* \*

Së fundi, edhe dy fjalë për prirjet e zhvillimit të çifteve në shqyrtim. Në këtë rast është e nevojshme që studimi të drejtohet në dy kahe. Nga njëra anë duhet të saktësohet gjendja ekzistuese e këtyre çifteve në gjuhën letrare të njësuar, struktura fjalëformuese e tyre në përgjithësi etj., nga ana tjetër, të shihen mundësítë dhe prirjet e zhvillimit të mëtejshëm të tyre në përporthje me lëvizjet dhe zhvillimin e leksikut në gjuhën shqipe. Siç e pamë edhe më lart, këto çifte në shumicën dërrmuese janë mbiemra, ndër të cilët njëra gjymtyrë është një fjalë e prejardhur me prapashtesim (herë-herë edhe me paranyjëzim) nga tema emërore — skema (*n+*) *tE + f* — *M*. Gjymtyra tjetër e krijuar mbi bazën e së parës del me skemën (*n+*) *f(tNum) + tM* — *M*. Formantet prapashtesore mbizotëruese janë -*or* dhe -*shëm*, ndërsa me denduri të ndryshme dalin edhe prapashtesat -*ak*, -*ik*, -*ar*, -*ës*, të gjitha të përdorura me kuptim përkatësor. Ky kuptim pasqyrat marrëdhënen e sendit të karakterizuar ndaj një sendi tjetër, duke treguar se sendi i karakterizuar e përmban sendin e emërtuar nga tema fjalëformuese e mbiemrit (p.sh. *dité*, *anë*). Ndërsa pasqyrat përbledhëse të modeleve fjalëformuese për secilën gjymtyrë të këtyre çifteve mbiemërore dalin si vijon:

- a) Gjymtyra e parë, me skemën (*n+*) *tE + F* — *M*  
*tE + or* — *M* (*ditor*, *anësor*, *kuptimor* etj.)  
*tE + (ë)s* — *M* (*gjakës*)  
*tE + ak* — *M* (*emërak*, *thundrak*)  
*tE + ik* — *M* (*bazik*, *atomik*)  
*tE + ar* — *M* (*polar*)  
*n + tE + shëm* — *M* (*i anshëm*, *i kuptimshëm*, *i hershëm* etj.)
- b) Gjymtyra e dytë, me skemën: (*n+*) *f(tNum) + M<sub>1</sub>* — *M<sub>2</sub>*  
*një + M<sub>1</sub>* — *M<sub>2</sub>* (*njëditor*, *njëgjakës*, *njëemnak*, *njëbazik*)  
*n + një + M<sub>1</sub>* — *M<sub>2</sub>* (*i njëanshëm*, *i njëkuptimshëm* etj.)

Duke vendosur këto lloj marrëdhëniash dhe për natyrën leksikogramatikore që kanë si emërtues të tipareve të mundshme të sendeve a të dukurive, këto çifte qëndrojnë në një varg të hapur, i cili zgjatet gjithmonë si rezultat i zhvillimit të shtresave të leksikut të shqipes<sup>20</sup>.

20) Kështu në FGjSSh gjejnë vend për herë të parë një varg njësish të reja leksikore, të cilat dalin si vijon: me prapashtesën -*or*: *anësor* — *njëanësor*, *ditor* — *njëditor*, *javor* — *njëjavor*, *kuptimor* — *njëkuptimor*, *mujor* — *njëmujur*, *shekullor* — *njëshekullor*, me prapashtesën -*shëm*: *i anshëm* — *i njëanshëm*, *i hershëm* — *i njëhershëm*, *i kuptimshëm* — *i njëkuptimshëm*, *i njëshëm* — *i njënjëshëm*, *i sipërfraqshëm* — *i njësipërfraqshëm*, *i vëllimshëm* — *i njëvëllimshëm*, *i vlershëm* — *i njëvlershëm*, *i zëshëm* — *i njëzëshëm*; me prapashtesën -*ak*: *emërak* — *njëemërak*, me prapashtesën -*(ës)*: *gjakës* — *njëgjakës*. Kemi lënë jashtë kësaj liste emrat që i përkasin mirëfilli sferës së terminologjisë shkencore.

Për më tepër, këta mbiemra, kur depërtojnë mirë në gjuhë, mund të shndërrohen me kalimin e kohës edhe në tema fjalëformuese për krijimin e njësive të reja leksiko-gramatikore. Kështu, p.sh., në FGjSSh vërejmë si njësi të veçanta, krahas çifteve mbiemërore gjegjëse, edhe çiftet emërore të prejardhura prej tyre me prapashtesat —(ë)ri, —(ë)si, si: *anshmëri* — *njëanshmëri*, *gjakësi* — *njëgjakësi*. Ndërsa si çifte ndaj-foljore dallojmë *anshmërisht* — *njëanshmërisht*, *anësisht* — *njëanësisht*. Çerdhe të tillë fjalësh mund të formohen edhe për çifte të tjera, duke u përdorur në rrëthana të caktuara dhe me nuanca kuptimore të veçanta. Por të, gjitha këto mundësi realizohen në gjuhë vetëm në rast se ekzistojnë si nevojë objektive, si pasqyrim gjuhësor i zhvillimit shogëror e kulturor të bartësve të saj.

### Zusammenfassung

#### ZUR BILDUNG EINIGER ADJEKTIVISCHEN PAARE DES TYPUS *ditor* «Tages» — *njëditor* «eintägig» IM ALBANISCHEN DER GEGENWART

Das Entstehen der neuen Wörter und die Entwicklung der neuen Bedeutungen bei den vorhandenen Worteinheiten stellen die zwei Hauptwege dar, die die Produktivität unserer Sprache ungewöhnlich gross gemacht haben, um den Wortschatz rasch und zweckmäßig den vielen lexiko-semantischen Anforderungen anzupassen. Diese zwei Vorgänge sind überhaupt nicht voneinander als völlig getrennt zu sehen, sondern in dialektische Zusammenhang, die sich, in ihrer Vielfalt, in der Sorte der semantischen und formalen Oppositionen, welche das Wort unter den Bedingungen des läufenden Verkehrs des Wortschatzes aufstellt, dargelegt wird.

Als Ergebnis solcher Oppositionen sieht der Verfasser das Entstehen mancher adjektivischen Paare, deren Glieder sich voneinander durch die An- und Abwesenheit des voranstehenden Zahlwertes *një* «ein» unterscheiden: *i anshëm* «seitig» — *i njëanshëm* «einseitig»; *i vlershëm* «wertbeständig» — *i njëvlershëm* «einwertig», *ditor* «tage(buch), Tages (lohn)» — *njëditor* «eintagig» usw.

Auf Grund einer detaillierten Analyse sowohl auf Wortbildungsebene, als auch auf semantischem Ebene ist der Autor zur Erklärung jener Beziehungen gekommen, die sich beim Verhältnis *Ableitungssstamm* — *abgeleitetes Wort* entwickelt haben.

Die in Frage stehenden adjektivischen Paare beweisen solche Verhältnisse auf dem synkron-formalen Aspekt: das erste Glied zeigt die Wortbildungsmodele (*n+*) *tE + f* — *M<sub>1</sub>*, während das zweite die Modele (*n+*) *tNum + tM<sub>1</sub>* — *M<sub>2</sub>*\*.

Eine auf semantischen Ebene durchgeföhrte Analyse beweist dafür, dass die Glieder jedes Paares, trotz der verschiedenen Beziehungen, die sie miteinander aufweisen, verfügen über eine gemeinsame semantische Achse, wonach jede neue lexikalische Einheit (die Modele (*n+*) *tNum + tM<sub>1</sub>* — *M<sub>2</sub>*), unter anderem, als Ergebnis des Entstehens differen-

\*) *n* — vorgestellter Artikel  
*tE* — substantivischer Stamm  
*tM* — adjektivischer Stamm

*tNum* — Zahlwortstamm  
*E* — Substantiv  
*M* — Adjektiv

zierter semantischen und formalen Oppositionen auf der semantischen und der Wortbildungs-Struktur der Ableitungseinheit (die Modelle  $(n+) tE + f \longrightarrow M_1$ ) zu betrachten ist. Zu diesen Schlussfolgerungen ist der Autor nach einer ausführlichen semantischen und Wortbildungs-Analyse des Paars *ditor* «Tage(s) — » — *njëditor* «eintagig» gekommen.

Zum Schluß erklärt der Autor die Stellung dieser adjektivischen Paare im lexikalischen System des Albanischen sogar auch die Tendenz ihrer Entwicklung binnen diesses Systems. Sowas hebt besser die spezifischen Eigenschaften des Albanischen in Vergleich mit jenen ähnlichen Strukturen anderer Sprachen (it *uni-*- *mono-*; fr. *uni-*, *mono-*, gjerm. *un-*) hervor.